



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 18 shtator 2017  
Nr. ref.:RK1122/17

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

**rastin Nr. KI32/17**

Parashtrues

**Afrim Radoniqi**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së  
Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Pml. nr. 276/2016,  
të 5 dhjetorit 2016**

**GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Bekim Sejdiu, gjyqtar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe  
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është dorëzuar nga Afrim Radoniqi nga Gjakova (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

## **Vendimi i kontestuar**

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme Pml. nr. 276/2016 i 5 dhjetorit 2016, me të cilin ishte refuzuar si e pabazuar kërkesa e parashtruesit për mbrojtjen e ligshmërisë kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PAKR. nr. 497/2016 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë PKR. nr. 105/2015.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, i cili pretendohet të ketë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 29 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 13 mars 2017, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 7 prill 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Bekim Sejdiu.
7. Më 14 prill 2017, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që ta plotësojë formularin e kërkesës dhe t'i bashkëngjisë Aktgjykimet e Gjykatës Themelore dhe të Gjykatës së Apelit. Të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
8. Më 3 maj 2017, parashtruesi i kërkesës dorëzoi formularin e plotësuar të kërkesës dhe aktgjykimet e kërkuara.
9. Më 5 shtator 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

10. Më 14 shtator 2012, parashtruesi i kërkesës, i cili ishte avokat publik i Komunës së Gjakovës, bleu një pronë të patundshme nga ZD. Kontrata u konfirmua nga Gjykata Themelore në Kralëvë të njëjtën ditë. Më pas, Drejtoria

e Kadastrës, Pronës dhe Gjeodezisë së Kuvendit Komunal të Gjakovës pezulloi dhe më vonë refuzoi regjistrimin e pasurisë së paluajtshme.

11. Më 11 prill 2013, parashtruesi i kërkesës, si përfaqësues i ZD, parashtroi ankesë pranë Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor - Agjencia Kadastrale e Kosovës, duke kërkuar regjistrimin e pasurisë së paluajtshme në Regjistrin Publik Kadastral.
12. Më 10 qershor 2015 dhe më 27 tetor 2015, Prokuroria në Gjakovë parashtroi aktakuzën PP/I. nr. 35/2015 dhe PP/I. nr. 22/2015 kundër parashtruesit të kërkesës për kryerjen e veprave penale të falsifikimit të dokumentit zyrtar, keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar dhe konfliktit të interesit.
13. Më 18 korrik 2016, Gjykata Themelore në Gjakovë (Aktgjykimi PKR. nr. 105/2015) e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor dhe e dënoi atë me pagesë me gjobë, sepse, ndërsa ishte i punësuar si avokat publik i Komunës së Gjakovës, ai parashtroi ankesë në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, duke e paraqitur veten si përfaqësues ligjor privat i ZD.
14. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit duke pretenduar *“shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkelje të ligjit penal dhe vendimit për dënim”*.
15. Më 20 shtator 2016, Gjykata e Apelit (Aktgjykimi PAKR. nr. 497/2016), aprovoi pjesërisht ankesën e parashtruesit të kërkesës, përkatësisht dënimin me gjobë më të ulët, duke pasur parasysh se parashtruesi i kërkesës *“të njëjtën kohë përfaqësonte klientin e tij Z. D. duke vepruar si përfaqësues ligjor i tij (...), duke iu drejtuar edhe Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë (...), duke paraqitur kështu ankesë në emër të tij kundër Vendimit të Drejtorisë së Gjeodezisë, Kadastrës dhe Pronës të Komunës së Gjakovës, duke mbajtur në të njëjtën kohë pozitën si avokat publik”*.
16. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, duke pretenduar *“shkelje të ligjit penal”* dhe *“shkelje esenciale të KPPRK-së”*. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës pretendoi se *“është shkelur Ligji material që vënë në dyshim të bazuar ligjshmërinë e Aktgjykimeve të goditura”*.
17. Më 5 dhjetor 2016, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Pml. nr. 276/2016) e refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, duke konsideruar se parashtruesi i kërkesës *“ka marrë pjesë në një procedurë administrative në Drejtorinë për kadastër, Pronë dhe Gjeodezi të Komunës së Gjakovës edhe pse në Komunën e Gjakovës e ka pas pozitën e avokatit publik. Andaj, janë përmbushur elementet qenësore të veprës penale për të cilën i dënuari është shpallur fajtor (...).”*

### **Ligji relevant**

### **Kodi Penal i Republikës së Kosovës nr. 04/L-082**

**Neni 424**  
**Konflikti i interesit**

1. Personi zyrtar i cili merr pjesë personalisht në ndonjë çështje zyrtare në të cilën ai apo ndonjë anëtar i familjes ose ndonjë person juridik që ka të bëjë me të ka interes financiar, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

[...]

4. Për qëllime të këtij neni, shprehja “çështje zyrtare” nënkupton procedurë gjyqësore ose procedurë tjetër zyrtare; aplikim, kërkesë për vendim ose përcaktim tjetër zyrtar; kontratë apo kërkesë; ankand publik ose veprim tjetër i prokurimit; ose ndonjë çështje tjetër e cila prek interesat financiare apo personale të zyrtarit apo personit tjetër.

**Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

18. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat e tij për barazi para ligjit, për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe mbrojtje të pronës.
19. Parashtruesi i kërkesës pretendon se “dispozitat e Kushtetutës dhe të Ligjit material (...) janë cenuar”, sepse vendimi i kontestuar “është tejet kontradiktor dhe konfuz, i njëjti nuk argumenton se ku qëndron konsumimi i veprës penale-cenimi i ligjit penal.”.
20. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se atij “i mohohet e drejta Kushtetuese për të drejtën në pronësi në paluajtshmëri, i mohohet e drejta që të ndërmerr veprime për të dalë në qarkullim juridik për blerje dhe shitje të paluajtshmërisë”.
21. Parashtruesi i kërkesës pretendon se “janë shkelur dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përkatësisht neni 24, pika 1, pika 2 (Barazia para ligjit), Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore me Protokollet e saj në Republikën e Kosovës, të zbatueshme me nenin 22 të Kushtetutës”.
22. Parashtruesi i kërkesës pretendon se të drejtat e tij “janë shkelur edhe përkundër faktit se këto të drejta janë garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut (...). Këto të drejta janë liria, PRONA, siguria dhe rezistenca ndaj shtypjes”.
23. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata, “që pas administrimit dhe vërtetimit të pretendimeve nga ankuesi, të bie vendim meritorë mbi pretendimet të parashtruara në ankesë nga ankusi Afrim Radoniqi.”, këtu parashtruesi i kërkesës.

**Pranueshmëria e kërkesës**

24. Gjykata i referohet nenit 46 [Lejueshmëria] të Ligjit, i cili parasheh:

*Gjykata Kushtetuese pranon dhe procedon kërkesën e ngritur sipas nenit 113, paragrafi 7 të Kushtetutës, nëse konstaton se janë plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara ligjore.*

25. Prandaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.
26. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës i cili përcakton:
1. *Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.  
[...]*
  7. *Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.*
27. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 49 [Afatet] të Ligjit i cili parasheh:
- Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht [...].*
28. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, ai konteston aktin e Gjykatës Supreme si autoritet publik, i ka shteruar mjetet juridike në dispozicion dhe ka paraqitur kërkesën e tij brenda afatit prej katër (4) muajve.
29. Megjithatë, Gjykata më tej i referohet nenit 48 të Ligjit i cili parasheh:
- Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.*
30. Përveç kësaj, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) (d) dhe 36 (2) (b) (d) të Rregullores së punës, i cili parasheh:
- (1) *Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
    - d) *kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*
  - (2) *Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
    - [...]
    - (b) *faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese.*

*(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”*

31. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton që parashtruesi kërkoi mbrojtje të ligjshmërisë duke pretenduar “*shkelje esenciale të KPPRK-së*” dhe “*shkelje të ligjit penal*”. Megjithatë, këto pretendime kanë të bëjnë me fushën e ligjshmërisë dhe si të tilla nuk bien nën juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese.
32. Në të vërtetë, parashtruesi kërkon nga Gjykata “*të bie vendim meritore mbi pretendimet të parashtruara në ankesë nga ankusi Afrim Radoniqi*”. Në thelb, parashtruesi i kërkesës i përsërit të njëjtat pretendime përpara kësaj Gjykate.
33. Gjykata vëren se Gjykata Supreme konsideroi që “*shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale (...) nuk janë precizuar*” dhe “*nuk është shpjeguar se për cilën shkelje (...) është fjala. Për më tepër, nuk është dhënë sqarim se konkretisht ku qëndrojnë mangësitë e aktgjykimeve kur është fjala për arsyetimi e fakteve vendimtare, por vetëm thuhet se ato mungojnë. Andaj, kjo gjykatë [Gjykata Supreme] konstatojë se pretendimet e këtilla nuk janë të bazuara*”.
34. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendoi edhe “*shkeljen e kodit penal*”, kryesisht duke pasur parasysh se vepra penale e konfliktit të interesit nuk ishte e zbatueshme në rastin e tij dhe se arsyet e dhëna me aktgjykimin e Gjykatës Supreme janë kontradiktore dhe konfuze; ato nuk shpjegojnë “*se ku qëndron konsumimi i veprës penale*”.
35. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se Gjykata Supreme konsideroi se gjykatat e shkallës më të ulët “*me vend kanë gjetur se në rastin konkret nuk bëhet fjalë për marrjen e vendimit nga i dënuari apo Zyra e Avokatit Publik por për veprimet tjera e të dënuarit*”, sepse “*ligji nuk kërkon që ai personalisht të jetë person i cili merr vendim por mjafton që personalisht të merr pjesë në 'ndonjë çështje zyrtare në të cilën ka interes financiar*”.
36. Përveç kësaj, Gjykata Supreme shpjegoi se “*si çështje zyrtare*” konform dispozitës së par. 4. të nenit 424. të KPK nënkuptohet “*procedurë gjyqësore ose procedurë tjetër zyrtare; aplikim, kërkesë për vendim ose përcaktim tjetër zyrtar; kontratë apo kërkesë; ankand publik ose veprim tjetër i prokurimit; ose ndonjë çështje tjetër e cila prek interesat financiare apo personale të zyrtarit apo personit tjetër*”.
37. Gjykata Supreme arriti në përfundimin se “*janë përmbushur elementet qenësore të veprës penale për të cilën i dënuari është shpallur fajtor*”.
38. Në lidhje me këtë, Gjykata konsideron se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme tërësisht arsyeton pretendimet e bëra nga parashtruesi i kërkesës. Gjykata Supreme shpjegon në hollësi se pse kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është hedhur poshtë si e pabazuar, duke konsideruar se faktet e rastit nuk janë të kontestueshme, duke vlerësuar pretendimet për shkelje esenciale të dispozitave procedurale penale dhe shkeljen e kodit penal, përkatësisht duke iu referuar interpretimit ligjor të dispozitave relevante dhe përkatëse të Kodit

Penal dhe duke vlerësuar vendimet e gjykatave të shkallës më të ulët në bazë të pretendimeve të ngritura nga parashtruesi i kërkesës.

39. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar dhe vërtetuar se procedurat dhe aktgjykimi i kontestuar ishin të padrejta ose arbitrare (Shih: rastin e GJEDNJ-së *Shub kundër Lituanisë*, kërkesa nr. 17064/06, Vendimi i 30 qershorit 2009).
40. Në fillim, Gjykata rikujton nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] që e përcakton se “*Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.*” Prandaj, Gjykata Kushtetuese, si “*autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës*” (neni 112 i Kushtetutës), është e detyruar të marrë parasysh praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së gjatë vlerësimit të shkeljeve të supozuara të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë.
41. Në lidhje me këtë, Gjykata përsërit se nuk është detyrë e saj sipas Kushtetutës të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, në lidhje me vendimet e marra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është të interpretojë dhe zbatojë rregullat përkatëse të të drejtës procedurale dhe materiale (Shih rastin e GJEDNJ-së: *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; shih gjithashtu rastin e Gjykatës Kushtetuese: nr. KI70/11, parashtruesit e kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendimi për papranueshmëri i 16 dhjetorit 2011).
42. Fakti i thjeshtë se parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e procedurës në rastin e tij, nuk mund të ngrejë një kërkesë të argumentueshme për shkelje të Kushtetutës (Shih rastin e GJEDNJ-së *Mezotur Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, kërkesa nr. 5503/02, Aktgjykim i 26 korrikut 2005).
43. Gjykata Kushtetuese mundet vetëm të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë kryer në mënyrë të tillë sa që parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë (Shih, rasti *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 13071/87, Komisioni Evropian për të Drejtat e Njeriut, 10 korrik 1991).
44. Parashtruesi më tej pretendon se atij “*i mohohet e drejta Kushtetuese për të drejtën në pronësi në paluajtshmëri*”. Në këtë drejtim, duket se parashtruesi i kërkesës përpiqet të bëjë një pretendim për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës.
45. Neni 46 [Mbrojtja e Pronës] i Kushtetutës përcakton:
  1. *E drejta e pronës është e garantuar.*
  2. *Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.*
  3. *Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona [...].*

46. Megjithatë, parashtruesi nuk arrin të ndërtojë një argument mbi baza kushtetuese. Në të vërtetë, Gjykata rikujton që e drejta në pronë zbatohet vetëm për pasuritë ekzistuese të një personi dhe nuk garanton të drejtën e fitimit të pronës. (Shih: *mutatis mutandis*, rasti i GJEDNJ-së *Marckx kundër Belgjikës*, nr. 6633/74, Aktgjykimi i 13 qershorit 1979, § 50).
47. Gjykata konsideron se rrethanat e rastit nuk i japin parashtruesit një titull të një interesi thelbësor të mbrojtur me nenin 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së.
48. Në fund, Gjykata me tutje rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se atij “i mohohet e drejta që të ndërmerr veprime për të dalë në qarkullim juridik për blerje dhe shitje të paluajtshmërisë”. Ai konsideron se ky mohim është shkelje e së drejtës për “barazinë e qytetarëve për të hyrë në mënyrë të lirë në transaksione juridike, gjithashtu është shkelur”. Kështu ai gjithashtu pretendon se gjykatat e rregullta kanë shkelur të drejtën e tij për barazi para ligjit të garantuar me nenin 24 të Kushtetutës.
49. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton që një trajtim është diskriminues nëse një individ trajtohet ndryshe nga të tjerët në pozita ose situata të ngjashme dhe nëse kjo diferencë në trajtim nuk ka arsytim objektiv dhe të arsyeshëm.
50. Gjykata thekson se trajtimi i ndryshëm duhet të ndjekë një qëllim legjitim për të qenë i justifikuar dhe duhet të ketë një marrëdhënie të arsyeshme të proporcionalitetit midis mjeteve të shfrytëzuara dhe qëllimit që kërkohet të arrihet (shih rastin e GJEDNJ-së *Marckx kundër Belgjikës*, kërkesa nr. 6833/74, Aktgjykim i 13 qershorit 1979, § 33).
51. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* dhe nuk i ka mbështetur pretendimet e tij, që tregon se ai ishte diskriminuar në procedurën pranë Gjykatës Supreme.
52. Si përmbledhje, Gjykata konkludon se faktet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës nuk e arsyetojnë pretendimin e tij për shkelje të të drejtave të tij për barazi para ligjit, gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe mbrojtjes së pronës. Në të vërtetë, parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar dhe as argumentuar pretendimin e tij se procedurat në Gjykatën Supreme ishin të padrejta ose arbitrare.
53. Prandaj, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (d) dhe 36 (2) (b) (d) të Rregullores së punës, Gjykata konstaton se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, dhe, në pajtim me nenin 46 të Ligjit, kërkesa është e papranueshme.



## PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113 (7) të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (d) dhe 36 (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 5 shtator 2017, njëzëri

### VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Almiro Rodrigues



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi